VENDIM
Nr.280, datë 10.5.2006

PËR CAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS SË AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË KREDIVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "b" të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë së Trajtimit të Kredive shpërblehen, për pjesëmarrje në këtë këshill në raportin: kryetari 30 për qind të pagës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe anëtarët 20 për qind të pagës së Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj ministrie.
2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë së Trajtimit të Kredive përfitojnë shpërblim, vetëm për pjesëmarrje në mbledhjet e këshillit. Kur Këshilli Mbikëqyrës zhvillon më tepër se një mbledhje në muaj, anëtarët përfitojnë shpërblim, sipas kuotës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, vetëm për mbledhjen e parë.
3. Ngarkohet Agjencia e Trajtimit të Kredive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 prill 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha